



Në bazë të Nenit 23 pika 15 e Statutit të FSHK-së, Kryesia e FSHK-së në mbledhjen e mbajtur me datën : 07.05.2021 , shqyrtoi dhe miratoi:

## **KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E SELEKTORIT TË PËRFAQËSUESES SË SHTETIT NË SHAH**

### **DISPOZITAT THEMELORE**

#### **Neni 1**

Për të kryer detyra të veçanta/specifike, Kryesia mund të zgjedhë dhe shkarkoj organet e përkohshme për të kryer këto detyra. Zgjedhja e organeve të përkohshme bëhet me propozimin e Kryesisë dhe ka mandat deri në përfundimin e një detyre të veçant të deleguar.

#### **Neni 2**

Emërimi i organit të përkohshëm për përzgjedhjen e selektorit/es të përfaqësueses së shtetit në shah bëhet me votën e shumicës së anëtarëve prezent të Kryesisë. Ky organ përbëhet nga kryetari dhe dy (2) anëtarë të bordit. Vendimet meren me shumicë votash dhe ato i verifikon Kryesia në mbledhjen e saj të ardhshme. Sekretari i Përgjithshëm merr pjesë në punën e këtyre organeve si fasilitues, por nuk e ka të drejtën e votimit.

#### **Neni 3**

Kriteret për përzgjedhjen e selektorit/es të përfaqësueses së shtetit në shah janë:

- 1) të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës;
- 2) të jetë anëtarë/e i/e FSHK-së;
- 3) të jetë nën moshën 70 vjeç/e dhe i/e aftë për punë ;
- 4) të jetë punëtorë/e i/e respektuar shahu apo shahist/e ;
- 5) të ketë përvojë minimum 20 vjeçare në lojën e shahut;
- 6) të ketë titull të shahistit/es apo Fide ELO mbi 2200 pikë (jo obligative);

- 7) të njohë njërën nga gjuhët zyrtare të FIDE-s : anglisht, frengjisht, gjermanisht ose rusisht,;
- 8) të ketë titull të trajnerit/es, minimum Instruktor/e FIDE, (jo obligative);
- 9) të mos jetë i/e larguar apo i/e suspenduar më herët nga FSHK;
- 10) të mos jetë i/e dënuar për vepra penale.
- 11) të mos jetë i/e dënuar ligjërisht për ndonjë vepër penale e cila bie ndesh me ligjet ndërkombëtare;
- 12) të paraqes plan-programin e tij/saj ne formë të shkruar;

#### **Neni 4**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Selektorit/es të përfaqësueses së shtetit në shah janë:

- a) Të përcaktoj kriteret për përzgjedhjen e reprezentacionit të Kosovës;
- b) Të përpiloj planin 4-vjeçar të pregaditjes së reprezentacionit;
- c) Të raportoj te Kryetari i Federatës dhe te kryesia për punën e tij/saj çdo 3-muaj;

#### **Neni 5**

Selektori/ja i/e përfaqësueses së shtetit në shah në mungesë rezultatesh apo mos realizim të plan-programit mund të shkarkohet me shumicë votash nga kryesia e Federatës në çdo kohë.

#### **Neni 6**

Kriteret e njejta të përzgjedhjes dhe shkarkimit të Selektorit/es të përfaqësueses së shtetit në shah aplikohen edhe me rastin e përzgjedhjes së Selektorit/es tek femerat si dhe tek të rinjtë.

Këto kritere për përzgjedhjen e Selektorit/es të përfaqësueses së shtetit në shah janë miratuar në Kryesinë e Federatës të mbajtur më datën:

Prishtinë, 07.05.2021

KRYETARI I FEDERATËS

z. Armend Budima



---